



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA TIRANË

**Drejtuar:** Operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk

**Adresa:** Tirane, Rruga “Don Bosko”, Pallati Meld, Kati i dyte

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PAS PËRFUNDIMIT TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”, “Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë) – Faza II”.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-64895-04-04-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Ndërtimi i tregut për shitjet me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore (Tirana Agrikulturë) – Faza II”.

Fondi limit: 43,046,031.55 (dyzet e tre milion e dyzet e gjashtë mijë e tridhjetë e një pikë pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj kalendarike.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Nr. 32 datë 11.04.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “ZEQILLARI” shpk** **NUIS L619120240**

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “2 N” shpk** **NUIS L31615017L**

Vlera e ofertës = **32,572,568** (tridhjetë e dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk** **NUIS K51712017A**

Vlera e ofertës = **33,907,496.51** (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION” shpk** **NUIS K66613407H**

Vlera e ofertës = **34,479,175** (tridhjetë e katër milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk** NUIS K61625001I

Vlera e ofertës = **35,722,795.83** (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e njëzet e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “STERKAJ” shpk** NUIS J68310708M

Vlera e ofertës = **36,377,627.90** (tridhjetë e gjashtë milion e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

**7. Operatori ekonomik “FLED” shpk** NUIS K17621104C

Vlera e ofertës = **36,868,554** (tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**8. Operatori ekonomik “ASI-2A CO” shpk** NUIS K53002402C

Vlera e ofertës = **37,014,959.57** (tridhjetë e shtatë milion e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

**9. Bashkimi i operatoreve ekonomik “BE - IS” shpk & “T & XH” shpk**

NUIS K71412003A & NUIS L72121504I

Vlera e ofertës = **38,246,758** (tridhjetë e tetë milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

**1. Operatori ekonomik “ZEQILLARI” shpk** NUIS L61912024O

Operatori ekonomik “ZEQILLARI” shpk nuk ka paraqitur formularin e ofertës ekonomikë cka bie ndë kundërshtim me pikën 1 të kriterëve të vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës I”*.

**2. Operatori ekonomik “2 N” shpk** NUIS L31615017L

Operatori “2N” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve të cilat duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.....”* pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar thjesht punonjës manovrator dhe jo punonjësin e kërkuar eskavatorist.

Operatori ekonomik “2N” shpk nuk plotëson 4 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi 65 (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës të vertetur me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat perkatëse.....”*, pasi në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka deklaruar se ka mesatarisht 65 punonjës nderkohe 22 punonjës rezultojnë të angazhuar në procedurën e prokurimit me objekt “Zgjerimi I

Varrezave publike Sharre”, ku eshte shpallur fitues. Pra, per sa me siper nuk ploteson numrin e punonjesve te kerkuar.

Operatori ekonomik “2N” shpk nuk plotëson 3 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.....*”, pasi është deklaruar i njëjti drejtues teknik I cili eshte deklaruar edhe ne procedurën e prokurimit me objekt “Zgjerimi I Varrezave publike Sharre”, ku eshte shpallur fitues, pra drejtuesi teknik rezulton I anagazhuar.

Operatori ekonomik “2N” shpk nuk plotëson 13 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht”, pasi mjetet e deklaruara rezultojne te njejta, pra te anagzhuara ne procedurën e prokurimit me objekt “Zgjerimi I Varrezave publike Sharre”, ku eshte shpallur fitues.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatori ekonomik “K A C D E D J A” shpk**, me adresë: *Tirane, Rruga “Don Bosko”, Pallati Meld, Kati i dyte*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **33,907,496.51** (tridhjetë e tre milion e nëntëqind e shtatë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: *Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **34,479,175** (tridhjetë e katër milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO